REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

NR. 1463 REP. NR. 512 KOL./ 1

**KONTRATË DHURIMI**
**KUOTA KAPITALI**

*Në Tiranë, sot më datë 05 Korrik 2018 (dymije e tetembedhjete), dite e enjte, para meje Noterit Alma I. POSHI, me seli në adresen: Rr. Sulejman Delvina, Tirane, u paraqitën personalisht shtetasit me cilesine e paleve kontraktuese:*

1. **Artan Sadikaj**, i datelindjes 26.05.1973, lindur ne Korçe, banues ne Elbasan, mbajtes i Leternjoftim ID nr. 032505300, numri personal H30526066P,
*ketu e ne vijim referuar **"Dhuruesi"**, **si edhe***
2. **Kujtim Skenderi,** i datelindjes 24.06.1976, lindur ne Frasher, Permet, banues ne Tirane, Rr. "S. Delvina", mbajtes i dokument identifikimi Leternjoftim ID nr. 029508676, me numer personal H60624162I,
*Ketu e ne vijim referuar "**Pranuesi i Dhurimit**";*

*Palet, persona madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë me kërkuan hartimin e kësaj Kontrate, me permbajtjen si vijon.*

**BAZA LIGJORE**

Neni 39/c i Ligjit nr. 7829 date 1.6.1994 "Për Noterinë; Neni 73/ç e vijues i Ligjit nr. 9901, date 14.4.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite Tregtare", Neni 204, 716 e vijues i K. Civill; Ligji Nr.131/2015 Per Q K B.

**MEQENËSE:**

A) Dhuruesi, është zotërues i 25% të kapitalit të shoqërisë "ALBANIA-PIEMONTE" SHPK, regjistruar me NUIS: L41524018Q, me seli në Tirane, (në vijim referuar si "**Shoqëria**").

B) Dhuruesi dëshiron t'i dhuroje Pranuesit te Dhurimit 25% të kapitalit të Shoqërisë dhe Pranuesi i Dhurimit dëshiron të pranoje nga Dhuruesi 25% të kuotave te kapitalit të Shoqërisë;

C) - Ky tranferim eshte miratuar nga asambleja e ortakeve te shoqerise date 05 Korrik 2018.

***Prandaj**, duke marrë parasysh sa më lart, Palët bien dakord si vijon:*

**NENI 1 – OBJEKTI I KONTRAËS**

**Me nënshkrimin e kësaj kontrate, dhe sipas kushteve vijuese, Dhuruesi, i dhuron Pranuesit te Dhurimit, 25% të kapitalit të Shoqërisë, dhe Pranuesi i Dhurimit behet se bashku me kuotat e tij ne kete shoqeri, ortak i shoqerise, zoterues i 75% të kapitalit të Shoqërisë "ALBANIA-PIEMONTE" SHPK.**

**NENI 2 – EFEKTET E TRANSFERIMIT**

2.1 Efektet e transferimit të kuotave të kapitalit të shoqërisë "ALBANIA-PIEMONTE" SHPK të përcaktuara në objektin e kësaj kontrate, nisin nga momenti i nënshkrimit të saj.

**NENI 3 – GARANCITË**

3.1 Dhuruesi i jep Pranuesit te Dhurimit të gjitha garancitë që parashikohen në K. Civil të R. Sh. për Dhuruesin, si dhe e garanton se këto kuota janë të lira nga çdo barrë si dhe për gëzimin e qetë të titullit të pronësisë.

**NENI 4 – TË NDRYSHME**

**4.1** Palet moren dijeni, dhe pranuesit te dhurimit i lind e drejta qe te regjistrojë këtë kontratë prane Regjistrit Tregtar QKB brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

*Kontrata pasi u redaktua, ju lexua paleve me ze te larte e qarte dhe meqenese shpreh vullnetin e tyre te lire e te plote, nenshkruhet prej tyre rregullisht dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.*

**DHURUESI** NOTERE **PRANUESI I DHURIMIT**

Sadikaj Artan Alma Poshi Kujtim Skenderi